

FJALA E DEPUTETIT ISUF ÇELAJ

Ë HËNË DATA 05 QERSHOR 2023

E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar qytetarë të Tropojës,

Të nderuar kolegë,

Problematikat dhe hallet e qytetarëve të Tropojës janë të shumta, pasi ju u vodhët votën duke blerë varfërinë e tyre. Sot jam përpara jush për të ngritur dy shqetësime shumë të mprehta të atyre banorëve, të cilat i kam ngritur edhe herë të tjera nga kjo foltore, por që deri tani kanë rënë në vesh të shurdhër të kësaj qeverie. Problematika e parë ka të bëjë me mungesën e investimeve në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes për furnizimin me energji elektrike të fshatrave të Luginës së Valbonës, zona më e bukur dhe piktoreske e alpeve shqiptare, ku numri i turistëve vendas dhe atyre të huaj ka ardhur në rritje nga viti në vit dhe veprimtaria e vetme për sigurimin e të ardhurave për familjet e këtyre fshatrave është turizmi. Është detyrë e qeverisë t’u sigurojë kushte për zhvillimin e një turizmi të qëndrueshëm, ku më kryesorja është furnizimi me energji elektrike 24 orë gjatë gjithë vitit për këta banorë, e cila nuk është siguruar, megjithëse ata i paguajnë rregullisht faturat e majme të energjisë elektrike. Linjat janë investime të vjetra e të shkatërruara. Zona prodhon energji, por energji nuk ka. Dy herë është shpallur procedura nga OSHEE-ja dhe në të dyja herët është anuluar me justifikimin se gjoja nuk ka fonde, nga thatësira apo nga situata energjetike në vend. Ky veprim është një diskriminim i pastër që kjo qeveri u bën këtyre banorëve. Investimet private në hotele dhe në bujtina po shtohen nga viti në vit, prandaj nevoja për investime serioze në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike është urgjente, pasi nuk mund të bëhet turizëm me gjenerator.

Thirrja ime e ripërsëritur shkon për zëvendëskryeminstren Balluku dhe drejtuesit e OSHEE-së, që të finalizohet me urgjencë procedura për furnizimin me energji elektrike të fshatrave të kësaj lugine, si: Klysyrrë, Dragobi, Valbonë, Rrogam i Shalës e Çerem, pjesë e bukurive natyrore e turistike të Luginës së Valbonës. Problematika tjetër ka të bëjë me gjendjen shqetësuese në të cilën ndodhen drurët e masiveve të gështenjës në Malësinë e Gjakovës. Sivjet, në masivet e pyjeve të gështenjës është shfaqur një insekt dëmtues shumë i rrezikshëm i quajtur “grerëza aziatike”, që shkakton rënien e prodhimit me 80%, duke i shkaktuar qytetarëve të këtij komuniteti një dëm ekonomik deri në 7-8 milionë euro në vit në të ardhurat që sigurohen nga prodhimi i frutit të gështenjave, mjaltit dhe lëndës drusore për mobilieri. Deri tani, metoda më e efektshme për të luftuar këtë insekt shkatërrues të gështenjës është ajo e kontrollit biologjik të grerëzës aziatike, që konsiston në instalimin e insektit, një agjent i suksesshëm i kontrollit biologjik të grerëzës. Për këtë kërkohet angazhimi i Ministrisë së Bujqësisë për sigurimin urgjent të këtyre insekteve nga jashtë, për shembull nga Italia, që të bëhet i mundur luftimi me sukses i kësaj sëmundjeje, duke qenë se fshatarët vetë e kanë të pamundur ta bëjnë këtë gjë. Tropoja ka gjithsej rreth 2800 hektarë masivë me gështenja, nga këto 2410 hektarë kanë qenë administruar nga ish-ndërmarrjet bujqësore, të ndodhura në fshatrat Gegëhysen, Gri, Bujan, Markaj, në zonën e Gashit, si edhe afro 400 hektarë në Lekbibaj, Shipshan, Dushaj i Epërm dhe

Demaliaj-Pac. Në vitin 1968, nga qeveria moniste, sipërfaqja prej 2410 hektarë është transferuar nga fondi i kadastrës pyjore dhe i ka kaluar në administrim ish-ndërmarrjeve bujqësore, dhe është përfshirë në fondin e drurëve frutorë. Nga ai vit e deri më sot, kjo sipërfaqe nuk është e regjistruar në regjistrin e pronave të shtetit në asnjë nga llojet e pronës. Kështu që, duke qenë pronë informale, pa status pronësie, pa administrim dhe mbrojtje shtetërore, është bërë objekt dëmtimesh dhe zjarresh të përvitshme. Ky burim natyror historikisht ka qenë pronë private derisa është shtetëzuar nga qeveria moniste dhe në vitin 1991 u la në rrugë të madhe, i braktisur, në vend që t'i transferohej ish-komunave (pushtetit vendor). Sot të gjitha sipërfaqet pyjore, pjesët shkëmbore, sipërfaqet e zhveshura, si edhe kullotat janë të regjistruara dhe administrohen nga shteti dhe kanë një punonjës pyjesh që përgjigjet për to, por gështenja jo. Asnjë fermer nuk ka certifikatë pronësie për kashnjetin e tij. Roli i shtetit shqiptar është të menaxhojë burimet natyrore të vendit, të kontrollojë, të administrojë, të drejtojë, të menaxhojë burimet natyrore të nëntokës dhe të mbitokës shqiptare dhe t'i vejë ato të ardhura në shërbim të qytetarëve shqiptarë. Qeverisja qendrore dhe vendore kanë për detyrë të hartojnë planin e menaxhimit, ta regjistrojnë këtë pasuri në regjistrin themelor të pronave të shtetit dhe çdo fermieri t'i japin certifikatën e pronësisë për pronën e tij. Qeverisja vendore ka detyrim kushtetues për të rehabilituar masivet e dëmtuara. Faleminderit!